



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROTOKOLLI 14

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 05.08.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin korrik 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve të pastreha që refuzohen nga perfitimi i “Subvencionimi i qirasë.”
5. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime në vendimin nr.100, datë 05.08.2026, “Për miratimin e moshës dhe kriterëve të regjistrimit në çerdhe Ersekë”.
6. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime në vendimin nr.101, datë 05.08.2026, “Për miratimin e tarifës vendore mujore fikse për frekuentimin në çerdhe dhe kopshtin me drekë, në kopshtin nr.2 “Marie Gjergo”, Ersekë”.
7. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e kalimit në pronësi të bashkisë Kolonjë të pasurive të paluajtshme.”
8. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullësor për korridor linje elektrike 110 kv parku fotovoltaike “Kolonjë “30 mw, shoqëria “Met Invest” Sh.p.k.”
9. **Projekt-Vendim** “Për vendosjen e çmimit të vërtetimit të transportit të produkteve pyjore dhe çmimin e certifikatës së origjinës të produkteve pyjore”.
10. **Projekt-Vendim** “Për mbështetjen financiare për organizimin e aktivitetit “food & drink 2026” dhe për shpërndarjen e fondeve buxhetore.”
11. **KËRKESË**

Të pranishëm: E. Xhelili, B.Jashari, A.Zeneli, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Çikopana H.Iljazi.

Mungon: I.Hodo, I.Milo, E.Avdi, S.Larti A.Tartari, T.Çaçani.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen rradhës së datës 27.08.2026, pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së dates 05.08.2026, të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin korrik 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”

Z.Meto: Pse familjet janë refuzuar nga sistemi?

A.Dajlani (Specialist i Shërbimit Social): Për muajin korrik janë rekomanduar të gjitha familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme në sistem, është refuzuar familja e Kozeta Lake dhe Ilir Veis, për kryerjen e proceduës së riaplikimit.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve të pastreha që refuzohen nga përfitimi i “Subvencionimi i qirasë.”

E.Xhelollari (Specialist i Shërbimit Social): Znj. Tone Nikoll Mahmut me statusin e gruas kryefamiljare, familja nuk përfiton më nga programi i subvecionimit të qirasë për shkak se ka përfituar banesë nga Fondacioni Fundjavë Ndryshe.

Z.Meto: Faleminderit nga Fondacioni Fundjavë Ndryshe.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës “Për disa ndryshime në vendimin nr.100, datë 05.08.2026, “Për miratimin e moshës dhe kriterëve të regjistrimit në çerdhe Ersekë”.

G.Tafili: Është problem mosha sepse nena kthehet në punë kur femija është në moshën 10 muaj, por mendoj që është një ide e mire që femija të shkojë në çerdhe pasi ka kryer vaksinimin e 12 muajit.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës “Për disa ndryshime në vendimin nr.101, datë 05.08.2026, “Për miratimin e tarifës vendore mujore fikse për frekuentimin në çerdhe dhe kopshtin me drekë, në kopshtin nr.2 “Marie Gjergo”, Ersekë”.

G.Tafili: Tarifa mujore do të jetë 4500 lekë nga të cilat 1500 lekë tarifë mirëmbajtje dhe 3000 lekë detyrim mujor për ushqimin.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatë të rendit të ditës “Për miratimin e kalimit në pronësi të bashkise Kolonje të pasurive të paluajtshme.”

P.Çunge: Na është paraqitur një projekt- vendim, ku ndodhen këto parcela?

G.Eminaj (Drejtore Drejtoria e Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH u la si detyrë kalimi në pronësi të Bashkisë gjitha pasuritë e paluajtshme. Në bazë të udhëzimit çdo pasuri do pajiset me certifikatë pronësie. Procedurat që ndiqen janë miratimi në këshillin Bashkiak, konfirmimi nga institucioni i Prefektit dhe më pas në ASHK.

Z.Meto: A figurojnë parcelat në fjalë si pronë private apo pronë shtetërore?

G.Eminaj (Drejtore Drejtoria e Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Të gjitha parcelat janë shtet.

P.Çunge: A ndikojnë në kullotë?

G.Eminaj (Drejtore Drejtoria e Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Jo sepse në qofte se banorëve ju duhet për kullotë ata mund ta marrin me qera në bashki.

Z.Meto: Do ketë përsëri prona për kalimin në pronësi të bashkise Kolonje të pasurive të paluajtshme.

G.Eminaj (Drejtore Drejtoria e Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Po janë diku të 2000 prona që do rivazhdojnë njëjtë procedure.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditës “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për korridor linje elektrike 110 kv parku fotovoltaike “ Kolonjë “ 30 mw, shoqëria “Met Invest” Sh.p.k.”

P.Çunge: Ku do kalojë linja.

G.Eminaj (Drejtore Drejtoria e Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Janë gjithsej 4 shtylla për tu vendosur. Linja shtrihet në fshatin Taç deri në fund të fshatit Psar.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën nëntë të rendit të ditës “Për vendosjen e çmimit të vërtetimeve të transportit të produkteve pyjore dhe çmimin e certifikatës së origjinës të produkteve pyjore”. G.Eminaj (Drejtor Drejtorisë së Pyjeve Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): çmimi i vërtetimeve të transportit të produkteve pyjore 300 Lek/Lejë dhe çmimin e certifikatës së origjinës të produkteve 100 Lek/certificate, ky çmim do të justifikojë edhe koston e prodhimit të tyre nga Institucioni Shtypshkrijës i Letrave me Vlerë për llogari të Bashkisë Kolonjë.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Duke qenë se na është paraqitur një projektvendim shtesë për shqyrtim, ju kërkohet të shprehni nëse jeni dakord me përfshirjen e tij në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dhjetë të rendit të ditës “Për mbështetjen financiare për organizimin e aktivitetit “food & drink 2026” dhe për shpërndarjen e fondeve buxhetore.”

E.Duro (Drejtorë Financie): Është hera e disatë që e prezantojmë këtë projekt vendim. Bashkia Korçë i është drejtuar Bashkisë Kolonjë me kërkesë për mbështetje financiare për organizimin e aktivitetit “KORÇA FOOD & DRINK 2026”, aktivitet i cili do të zhvillohet brenda vitit 2026. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Bashkia Kolonjë do të promovohet si partner i aktivitetit, përmes spoteve promocionale gjatë realizimit të eventit.

Z.Meto: Shpresojmë që do jetë i miratuar nga ana e institucionit të prefektit ky projekt vendim.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 27.08.2026 është firmosur nga 9 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS



**KRYETAR I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI**

